

VENDIM
Nr.200, datë 24.3.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.775, DATË 14.12.2005 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KOMPETENCAT, PËRBËRJEN, FUNKSIONIMIN DHE
MËNYRËN E MBLEDHJES DHE SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KOMISIONIT
SHTETËROR TË MUZEVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 16 të ligjit nr.9386, datë 4.5.2005 “Për muzetë”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.775, datë 14.12.2005 të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Komisioni Shtetëror i Muzeve të kryesohet nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe në përbërje të ketë këta anëtarë:

- Drejtorin e Muzeut Historik Kombëtar;
- Drejtorin e Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore;
- Dy përfaqësues nga struktura përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, pranë Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;
- Një përfaqësues nga struktura juridike, pranë Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;
- Një përfaqësues nga Akademia e Shkencave;
- Një përfaqësues nga Instituti i Arkeologjisë;
- Një përfaqësues nga Instituti i Antropologjisë Kulturore;
- Një përfaqësues nga Këshilli Ndërkombëtar i Muzeve (ICOM) në Shqipëri;
- Një përfaqësues nga Instituti i Monumenteve të Kulturës;
- Një përfaqësues nga Instituti i Historisë;
- Një përfaqësues nga fusha e muzeologjisë.

Përfaqësuesit e institucioneve të sipërpërmendura caktohen me urdhër të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.”.

2. Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Anëtarët e komisionit, të cilët nuk punojnë në sistemin e institucioneve shtetërore, të shpërblehen me 5 000 (pesë mijë) lekë, por jo më shumë se për një mbledhje në muaj.”.

3. Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8. Paga për shpërblimin të përballohet nga buxheti i Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha